

## **NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE**

**Pozicioni: Lektor / Pedagog**

**Tipologjia: Me kohë të plotë**

**Data e fillimit: Shtator 2026**

**Afati i aplikimit: 24 Maj 2026**

### **Fakulteti**

Fakulteti i Ekonomisë

### **Departamentet**

- Departamenti i Informatikës Ekonomike
- Departamenti i Shkencave Administrative
- Departamenti Financë-Bankë

### **Rreth UMT**

Universiteti Metropolitan Tirana është një nga institucionet lider të arsimit të lartë në Shqipëri, i përkushtuar ndaj ekselencës akademike, inovacionit, ndërkombëtarizimit dhe bashkëpunimit me industrinë. Universiteti përbëhet nga tre fakultete: Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT.

Në vitet e fundit, UMT ka forcuar fokusin strategjik në:

- metodologji inovative dhe student-centered të mësimdhënies;
- kërkim shkencor të aplikuar dhe zhvillim akademik;
- ekosisteme të sipërmarrjes dhe inovacionit;
- partneritete ndërkombëtare dhe projekte Erasmus+;
- bashkëpunime me universitete dhe industri evropiane dhe ndërkombëtare.

Në kuadër të zgjerimit akademik, UMT fton aplikime nga akademikë shqiptarë dhe të huaj për pozicione me kohë të plotë në Fakultetin e Ekonomisë.

### **Përshkrimi i Pozicionit**

Kandidati i përzgjedhur do të kontribuojë në mësimdhënie, kërkim shkencor, zhvillim të kurrikulave dhe aktivitete akademike në fushat:

- Financë;

- Kontabilitet;
- Ekonomi;
- Administrim Biznesi;
- Menaxhim;
- Informatikë Ekonomike;
- Analizë të të Dhënave dhe Metoda Kuantitative;
- Bankë dhe Teknologji Financiare;
- Fusha të tjera të lidhura ndërdisiplinore.

Kandidati ideal duhet të demonstrojë ekselencë akademike, aftësi inovative në mësimdhënie, angazhim në kërkim shkencor dhe përkushtim ndaj suksesit të studentëve.

### **Detyrat dhe Përgjegjësitë**

Personi i emëruar do të ketë përgjegjësi për:

- Zhvillimin e leksioneve, seminareve dhe aktiviteteve praktike;
- Hartimin dhe përditësimin e syllabuseve dhe materialeve mësimore;
- Përdorimin e metodave bashkëkohore dhe teknologjike të mësimdhënies;
- Ofrimin e mentorimit dhe mbështetjes akademike për studentët;
- Pjesëmarrjen në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë;
- Kontributin në zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimit;
- Angazhimin në kërkim shkencor, publikime dhe projekte akademike;
- Pjesëmarrjen në konferenca, trajnime dhe bashkëpunime ndërkombëtare;
- Mbështetjen e proceseve të akreditimit dhe ndërkombëtarizimit;
- Bashkëpunimin në nivel departamenti dhe ndërdisiplinor;
- Përbushjen e detyrave administrative dhe akademike;
- Respektimin e etikës akademike dhe rregulloreve institucionale.

## Aftësitë, Përvoja dhe Kualifikimet e Kërkuara

### Kriteret Thelbësore

- Gradë shkencore PhD ose në përfundim të doktoraturës në:
  - Financë,
  - Kontabilitet,
  - Ekonomi,
  - Administrim Biznesi,
  - Menaxhim,
  - Informatikë Ekonomike,
  - ose fusha të ngjashme;
- Njohuri shumë të mira të gjuhës angleze (minimumi niveli C1);
- Përvojë në mësimdhënie universitare ose trajnim profesional;
- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe prezantimi;
- Aftësi për të punuar në mjedise akademike ndërkombëtare dhe multidisiplinore.

### Aftësi Plotësuese dhe Kualifikime

Përparësi do të kenë kandidatët me:

- Publikime shkencore në revista të indeksuara;
- Eksperiencë në projekte kërkimore ose bashkëpunime ndërkombëtare;
- Eksperiencë profesionale në industri;
- Eksperiencë me platformat digjitale të mësimdhënies;
- Pjesëmarrje në projekte Erasmus+;
- Ekspertizë në data analytics, AI në biznes, fintech ose transformim digjital.

### Çfarë Ofrojmë

UMT ofron një mjedis akademik frymëzues dhe ndërkombëtar që mbështet zhvillimin profesional, inovacionin dhe ekselencën akademike. Kandidatët e përzgjedhur do të përfitojnë nga:

- Pagesë konkurruese në përputhje me kualifikimet dhe eksperiencën.
- Mundësi për të kontribuar në zhvillimin institucional dhe përmirësimin e kurrikulave;
- Mbështetje për kërkimin shkencor, publikimet dhe iniciativat inovative;
- Një mjedis pune dinamik, multidisiplinor dhe të orientuar drejt kërkimit shkencor;
- Akses në infrastrukturë moderne mësimore dhe platforma digjitale;
- Bashkëpunim me akademikë dhe partnerë industrie vendas dhe ndërkombëtarë;
- Pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare, konferenca dhe programe Erasmus+;
- Mundësi për zhvillim akademik dhe profesional;

### **Dokumentacioni për Aplikim**

Kandidatët duhet të dorëzojnë elektronikisht:

- Letër motivimi;
- CV;
- Listën e publikimeve dhe aktiviteteve akademike;
- Kopje të diplomave dhe listave të notave;
- Dëshmi të gradës PhD ose statusit të doktoraturës;
- Dëshmi të njohjes së gjuhës angleze;
- Kontaktet e të paktën dy referuesve akademikë/profesionalë.

Për diplomat e huaja duhet të paraqitet dokumenti i njohjes nga autoriteti kompetent shqiptar ose vërtetim që procesi është në zhvillim.

### **Procedura e Aplikimit**

Aplikimet duhet të dërgohen në adresën:

✉ [humanresources@umt.edu.al](mailto:humanresources@umt.edu.al)

Subjekti i email-it duhet të jetë:

“Aplikim për Pozicion Akademik me Kohë të Plotë – Fakulteti i Ekonomisë”

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.